



**Manual Shpjegues dhe Trajnues mbi
Hartimin e Planit të Komunikimit,
Informimit dhe Angazhimit mbi
Procedurat Transparente dhe Efektive
të Grantdhënies**

-1-

*Përgatitur nga
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile*

Prill 2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

TREGUESI I LËNDËS

KAPITULLI I

Hyrje.....	Faqe 3
Qëllimi i Manualit.....	Faqe 4

KAPITULLI II

Koncepte dhe Parime të Përgjithshme	Faqe 4
2.1. Parime të Përgjithshme.....	Faqe 4
2.2. Fjalor Shpjegues i Termave.....	Faqe 5

KAPITULLI III

Roli i Organeve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Realizimin e Komunikimit dhe Informimit	Faqe 7
---	--------

KAPITULLI IV

Procesi Konsultativ.....	Faqe 7
Integrimi i Sugjerimeve në Planin Financues.....	Faqe 8

ANEKS

Grupi i Ekspertëve.....	Faqe 8
-------------------------	--------

BIBLIOGRAFIA	Faqe 9
---------------------------	--------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

KAPITULLI I

Hyrje

Veprimtaria publike në tërësi, karakterizohet nga funksionet e ushtruara nga organet e qeverisjes qëndrore dhe lokale. Në funksion të këtij ushtrimi kompetence, bazuar në zhvillimet e fundit dhe kërkesat e duhura, prej këtyre organeve, kërkohet marrja e një mendimi, sugjerimi dhe orientimi të target- grupeve të interesuara por edhe të publikut të gjerë me qëllim, plotësimin e të gjitha kërkesave të nevojshme dhe përfshirjen e tyre në pjesën materiale të çdo lloj politike të synuar për implementim.

Rol të rëndësishëm në këtë sipërmarrje, luan dhe zbatimi i planit të komunikimit dhe informimit përmes angazhimit në rritje të grupeve të interesuara të cilat, ndër të tjera, kanë rol vendimtar në formësimin e politikave mbështetëse financiare në funksion dhe në të mirë të publikut.

Për të mbështetur edhe formalisht këtë nevojë, legjislatori shqiptar, ka krijuar Ligjin Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” ku në nenin tre të tij përcakton se fusha e zbatimit të Ligjit është për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik të zhvilluara nga organet publike në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse.

Ndaj, bazuar në Ligjin Nr. 146/ 2014 por edhe në akte të tjera organike, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, krijon këtë manual me karakter orientues dhe zbatues në funksion të masave të ndërmarra me qëllim, zbatimin e vetë ligjit por edhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 459 datë 27.05.2015 “Për Miratimin e Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Qëllimi i Manualit

Qëllimi i realizimit të këtij manuali konsiston në informimin e publikut të gjerë por edhe të target- grupeve të interesuara mbi procesin e politikë- bërjes në funksion të mbështetjes financiare të organizatave të shoqërisë civile.

Përmbajtja e shprehur në të, është domosdoshmërisht pasojë e legjislacionit shqiptar mbi procesin e konsultimit publik.

KAPITULLI II

Koncepte dhe Parime të Përgjithshme

2.1. Parime të Përgjithshme

Komunikimi, informimi dhe konsultimi publik, mbështetet në parime të pranuar tashmë mbarëkombëtare duke respektuar rigorozikisht, çdo element frytdhënës dhe orientues në të mirë dhe për interes të politikbërjes nga organet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Ky proces, mbështetet në:

- a. Parimin e Transparencës përgjatë tërë realizimit të procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- b. Parimin e Efekshmërisë së procesit të vendimmarrjes së organeve publike;
- c. Parimin e përgjegjësisë së organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore ndaj palëve të interesuara;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

2.2. Fjalor Shpjegues i Termave

Autoritet Financues:	Në kuptim të Ligjit Nr. 10 093/ 2009 është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe/ ose çdo autoritet, qendror apo vendor që shpërndan fonde nga buxheti i vet për mbështetjen e shoqërisë civile;
Kandidat:	Është çdo subjekt përfitues, që merr pjesë në një procedurë konkurrimi;
Granti:	Është shuma e përcaktuar e fondit për mbështetjen e shoqërisë civile, e shpallur në dokumentet e konkurrimit, gjatë një procedure konkrete, që i dhurohet pa interes subjektit përfitues nga autoriteti financues, në përputhje me kriteret e vendosura;
Dokumente:	Janë dokumentet e konkurimit, që autoriteti financues ua vë në dispozicion të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve;
Shpenzime:	Janë shpenzimet, që merren parasysh për një fond, për mbështetjen e shoqërisë civile;
Veprimtari:	Është çdo veprimtari, që ka si qëllim bazë realizimin e një interesi publik;
Akt nënligjor normativ:	Është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron me zbatimin e tij;
Grup Interesi:	Është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

- Konsultim Publik:** Është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij;
- Njoftim paraprak:** Është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e dhënies së informacioneve ose opinioneve paraprake, përpara fillimit të hartimit të projektaktit;
- Organ Publik:** Është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative, çdo organ i pushtetit vendor, që kryen funksione administrative, çdo organ i Forcave të Armatosura e çdo strukturë tjetër, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike;
- Rekomandim:** Është çdo sugjerim, propozim apo mendim me karakter konsultativ për projektaktet e hartuara, i shprehur verbalisht dhe/ose me shkrim nga palët e interesuara;
- Takim Publik:** Është çdo takim i hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me këto projektakte, si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre;
- Transparencë:** Është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

KAPITULLI III

Roli i Organeve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Realizimin e Komunikimit dhe Informimit

E tërë struktura organike e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, me rastin e realizimit të politikave të saj financuese për subjektet e shoqërisë civile, angazhohet seriozisht në planifikimin e takimeve gjithëpërfshirëse të territorit të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria, nis me evidentimin e zonave të thella në të cilat synohet ndërhyrja dhe ndërgjegjësimi varësisht strategjive qeveritare të paracaktuara për çdo vit.

Kështu, caktohen vende indentifikuese dhe gjithëpërmbledhëse të këtyre zonave dhe paraprakisht, njoftohet grupet e interesit përmes komunikimeve zyrtare të deklaruara pranë databazës së Institucionit por edhe në rrjetet zyrtare të administruara nga vetë Institucioni.

Komunikimi për realizimin e takimit vijon edhe përmes telefonimit të secilit përfaqësues ligjor të organizatave ku, individualisht, secili prej tyre, ftohet të marrë pjesë në këto takime.

Kryesisht, përcaktohen 5 (pesë) takime konsultative duke i'u referuar 2 (dy) zonave të veriut dhe 2 (dy) të jugut ndërsa takimi përmbledhës, së bashku me çdo sugjerim, orientohet në qytetin e Tiranës si qyteti identifikues më aktiv për organizatat e shoqërisë civile.

KAPITULLI IV

Procesi Konsultativ

Procesi konsultativ inicohet përmes shpalljes publike të iniciativës së ndërmarrë nga ku, thirren të gjithë subjektet përfituese por edhe target- grupet për pjesëmarrje dhe dhënie të konkluzioneve përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Ndodhur në këtë situatë, stafi i AMShC- së, mban shënimet përkatëse në formë përmbledhëse dhe pas realizimit të takimit, çdo mendim, kërkesë, sugjerim apo informacion, mbahet shënim për një fazë të dytë të procesit e cila ka të bëjë me formësimin e prioriteteve finale.

Integrimi i Sugjerimeve në Planin Financues

Subjektet pjesëmarrëse në takimin konsultativ, duke qenë se i njohin edhe më nga pranë problematikat sociale dhe shoqërore, angazhohen seriozisht në nxjerrjen e konkluzioneve mbi atë se çfarë në të vërtetë nevojitet për një zonë të caktuar.

Propozimet duhet të jenë të natyrave të ndryshme, duke nisur nga lloji i financimit e deri te proceset lehtësuese të politikave fiskale të qeverisë.

Me realizimin në tërësi të këtyre takimeve, stafi i AMShC- së, përgatit një procesverbal përmbledhës të të gjitha sugjerimeve të ndara përkatësisht me pika orientuese për çdo lloj strategjie e cila synohet të implementohet.

Në fund të këtij procesi, komisioni përgjegjës, shpall në faqen e tij zyrtare të gjithë informacionin e mbledhur, problematikën e shfaqur por edhe mënyrën e zgjidhjes së saj dhe normalisht, këto sugjerime, i përcillen Bordit Mbikqyrës të AMShC- së si organi më i lartë vendimmarrës në Institucion.

ANEKS

Grupi i Ekspertëve

- | | |
|---------------------|------------------------------------|
| 1. Znj. Paula BERO | - Specialiste e Financës |
| 2. Z. Alkent SHEHAJ | - Inspektor |
| 3. Z. Ferhat AGA | - Specialist- Grantet e Zhvillimit |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

BIBLIOGRAFIA

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligji Nr. 10 093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 769 datë 15.07.2009 “Për Miratimin e Statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” (i ndryshuar);
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 459 datë 27.05.2015 “Për Miratimin e Udhërrëfyesit për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile”;
5. Ligji Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;